

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 14, datë 31.05.2018

**Mbi miratimin e Planit Strategjik të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave
për vitet 2018-2020**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, me propozim të Komitetit të Strategjisë në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, i ngritur me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 33, datë 12.12.2017, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Planin Strategjik të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitet 2018-2020, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.
3. Ngarkohen strukturat e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar




AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE




PLANI STRATEGJIK 2018- 2020

www.asd.gov.al
t: +355 (4) 2362 989/2347 298
f: +355 (4) 2362 984
e: info@asd.gov.al
Rruga e Elbasanit, Nr. 317, Tiranë



Tryeza e lëndës

Profili i Agjencisë	2
Misioni, Vizioni dhe Vlerat e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave	4
Prioritetet strategjike 2018-2020	5
Rreziqet në përmbushjen e prioriteteve strategjike.....	6
Plani Strategjik 2018-2020	7
Prioriteti Strategjik I	7
Prioriteti Strategjik II	21
Prioriteti Strategjik III	25
Plani Financiar 2018 - 2020.....	30
Supozimet kyç të planifikimit.....	33
Performanca e Planit Strategjik 2015-2017	34
Përfundim.....	39




Profili i Agjencisë

Agjencia e Sigurimit të Depozitave (“Agjencia” ose “ASD”) është një institucion i pavarur i themeluar në vitin 2002 në bazë të ligjit nr. 8873, datë 29 mars 2002, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar me ligjin nr. 10106, datë 30 mars 2009 dhe ligjin nr. 78/2012, datë 26 korrik 2012. Nga muaji korrik i vitit 2014, aktiviteti i Agjencisë rregullohet nga ligji nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar me ligjin nr. 39/2016 dhe ligjin nr. 132/2016 (“Ligji” ose “Ligji për sigurimin e depozitave”). Në përputhje me ligjin për sigurimin e depozitave, Agjencia i raporton Bankës së Shqipërisë (“Autoriteti Mbikëqyrës”), Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. ASD-ja është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave dhe e Forumit Europian të Siguruesve të Depozitave. Agjencia është themeluar me qëllim sigurimin dhe kompensimin e depozitave në bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit (“SHKK - të”) që operojnë në Shqipëri. Anëtarësimi në skemën e sigurimit të depozitave është i detyrueshëm për të gjitha institucionet e licencuara nga Banka e Shqipërisë që mbledhin depozita.

Bazuar në ligjin për sigurimin e depozitave, Agjencia siguron dhe kompenson deri në 2,500,000 Lek depozituesit në çdo bankë anëtare të skemës së sigurimit. Njëkohësisht, Agjencia siguron dhe kompenson deri në 2,000,000 Lek depozituesit anëtarë në çdo shoqëri kursim-krediti anëtare e skemës së sigurimit.

Agjencia ushtron funksionet e saj, me qëllim përmbushjen e objektivave në zbatim të ligjit për sigurimin e depozitave. Në veçanti, por jo vetëm, Agjencia anëtarëson dhe përjashton subjektet në skemë; verifikon të dhënat e raportuara periodikisht nga subjektet anëtare; kryen verifikime të plota dhe të pjesshme në lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave në subjektet anëtare; zhvillon veprimtari për ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për skemën e sigurimit të depozitave; kompenson depozitat, sipas dispozitave të këtij ligji; arkëton kontributet fillestare, primet e





sigurimit, dhe kontributet e jashtëzakonshme; dhe investon mjetet financiare, sipas dispozitave të këtij ligji.

Me ligjin nr.133/2016 datë 22.12.2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar në kuadër të paketës ligjore të rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme në Shqipëri, me autoritet përgjegjës Bankën e Shqipërisë në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Agjencisë i janë ngarkuar edhe detyra të tjera shtesë. Në këtë ligj, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave i janë caktuar kompetenca për administrimin e fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, fond i cili përbëhet nga kontributet e bankave dhe përdoret sipas dispozitave ligjore në rastet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Agjencia e nisi veprimtarinë e saj më 12 tetor 2002. Aktualisht adresa dhe zyrat qendrore të Agjencisë janë në Tiranë (“Rruga e Elbasanit”, Tiranë, Shqipëri).

Paraqitje skematike e skemës së sigurimit dhe kompensimit të depozitave





Misioni, Vizioni dhe Vlerat e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

VIZIONI I AGJENCISË

Të jemi siguruesi i depozitave që **meriton besimin e publikut**.

MISIONI I AGJENCISË

Të **mirë administrojmë** skemën e sigurimit të depozitave.

VLERAT E AGJENCISË


Integriteti - Veprojmë me Integritet për realizimin e misionit tonë.

Puna në Grup - Punojmë në Ekip për të forcuar komunikimin dhe bashkëpunimin efektiv.

Përkushtimi - Jemi të Përkushtuar për përmbushjen e objektivave ligjore.

Transparenca – Qasje Transparente në kulturën tonë të punës.

Përgjegjshmëri - Përgjegjshmëri në administrimin e të gjitha kapaciteteve institucionale.



Prioritetet strategjike 2018-2020

Në hartimin e Planit Strategjik 2018-2020 janë përcaktuar tre prioritetet strategjike të Agjencisë, të cilat drejtojnë objektivat dhe iniciativat kryesore të veprimtarisë së Agjencisë përgjatë periudhës së planifikimit.

I. Efikasiteti i Skemës së Sigurimit të Depozitave


Të zhvillojmë një skemë sa më efektive të sigurimit të depozitave duke bërë një planifikim sa më realist në përputhje me iniciativat e Agjencisë dhe ato të bashkërenduara me institucionet e rrjetit të sigurisë financiare, duke kontribuar në këtë mënyrë në besueshmërinë e publikut dhe stabilitetin e sistemit financiar.

II. Menaxhimi i Kapitalit Njerëzor

Të krijojmë një ambient pune avantazhues për punonjësit, i cili promovon standarde të larta profesionale dhe efektivitet, duke u fokusuar në menaxhimin e kapitalit njerëzor dhe mësimin e vazhdueshëm.

III. Zhvillim Strategjik i Partneritetit

Të angazhohemi në një përfaqëse strategjike me partnerët kyç për aktivitetin e Agjencisë duke synuar një koordinim sa më efikas në të gjitha nivelet e bashkëpunimit, me qëllim garantimin e suksesit të iniciativave të parashikuara në këtë Plan Strategjik.



Rreziqet në përmbushjen e prioriteteve strategjike


Identifikimi, vlerësimi, adresimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i rreziqeve, është një proces shumë i rëndësishëm në zbatimin me sukses të Planit Strategjik. Mos administrimi efikas i rreziqeve mund të ndikojë në përmbushjen e një ose më shumë prej drejtimeve strategjike të Agjencisë. Rreziqet që mund të pengojnë Agjencinë në arritjen e objektivave të saj strategjike grupohen në rreziqe financiare, rreziqe në kompensim, rreziqe operacionale dhe rreziqe të ambientit të jashtëm.

Grupi më i rëndësishëm i rreziqeve, rreziqet financiare, përfshin grupin e rreziqeve që sjellin luhajtje në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Agjencisë. Në këtë kategori përfshihen rreziku i tregut, rreziku i likuiditetit dhe rreziku i kredisë. Administrimi i vazhdueshëm i këtyre rreziqeve siguron një skemë të shëndetshme financiarisht.

Rreziqet në sigurim dhe kompensim, kanë të bëjnë me gatishmërinë për të kryer një proces kompensimi efektiv, në përputhje me mandatin e Agjencisë. Disa prej rreziqeve të identifikuar janë kontrolluar nëpërmjet lidhjes së marrëveshjes me bankën agente, zhvillimin e SIRK dhe disa të tjera priten të kontrollohen nëpërmjet iniciativave strategjike (si p.sh. ushtrimet e simulimit, përmirësimi i cilësisë së të dhënave apo automatizimi i mëtejshëm i sistemit IT) pjesë e këtij plani strategjik.

Për përmbushjen në kohë dhe me cilësi të objektivave dhe iniciativave strategjike duhet të administrohen edhe rreziqet operacionale të cilat shfaqen gjatë kryerjes së proceseve të brendshme të institucionit, dhe lidhen kryesisht me rrezikun njerëzor, të teknologjisë së informacionit etj. E rëndësishme është që këto rreziqe të identifikohen saktë deri në detaje.

Administrimi i rreziqeve të ambientit të jashtëm, ku përfshihen rreziku mediatik, rreziku i perceptimit të imazhit apo dhe ngjarje të pa kontrollueshme do të ndihmojnë në zbatimin e objektivit strategjik për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe besimit të publikut.




Plani Strategjik 2018-2020

Prioriteti Strategjik I


Efikasiteti Skemës së Sigurimit të Depozitave

Agjencia, si një institucion anëtar i rrjetit të sigurisë financiare përgjegjës për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, ka përgjegjësinë direkte të punojë me qëllim ngritjen e një regjimi efektiv të sigurimit të depozitave në vend. Gjatë punës sonë ne udhëhiqemi nga parimet bazë ndërkombëtare të sigurimit të depozitave për të siguruar një regjim sa më efektiv të kompensimit të depozitave, të përshtatur sipas mjedisit tonë, që synon të mundësojë rregullimin dhe administrimin e procesit të kompensimit të depozitave në vend në mënyrë sa më efektive. Në këtë kuadër, Agjencia do të vijojë të punojë që të sigurojë gatishmërinë operationale për të përmbushur mandatin e saj.

Përmbushja e rolit tonë si siguroes depozitash do të thotë që të jemi gati dhe vigjilentë për ngjarje që mund të kërkojnë ndërhyrjen e Agjencisë duke zotëruar kapacitetet dhe aftësitë për të parashikuar, vlerësuar me kujdes dhe menaxhuar risqet me të cilat mund të përballen fondet e sigurimit të depozitave. Gjatë periudhës tre-vjeçare, përfshirë në këtë Plan Strategjik, Agjencia do të vazhdojë t'i përqendrojë përpjekjet e saj në rritjen e ekspertizës për përmbushjen e detyrimit të saj ligjor, në rast ngjarje sigurimi, me anë të kompensimit apo metodave të tjera në përputhje me dispozitat ligjore dhe kuadrin rregullator në fuqi. Puna jonë do të synojë në arritjen dhe ruajtjen e një niveli optimal gatishmërie, sipas standardeve ndërkombëtarisht të pranuara, për t'ju dhënë depozituesve aksesin më të shpejtë të mundshëm në kursimet e tyre, në rast ngjarje sigurimi. Me këtë qëllim, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përgatitjes, organizimit dhe kryerjes së ushtrimeve të simulimit, duke synuar dhe përfshirjen e institucioneve të rrjetit të sigurisë financiare, subjekteve mbështetëse dhe të anëtarëve të skemës së sigurimit të depozitave të madhësive të ndryshme, sa i përket numrit të depozitave të siguruara. Në vijim janë renditur iniciativat kryesore në funksion të objektivave të këtij prioriteti strategjik.



Objektivi	Iniciativat Kryesore
<p>Gatishmëria operacionale për kompensim</p>	Përmirësimi dhe rritja e gatishmërisë së infrastrukturës teknologjike lidhur me sistemin e raportimit.
	Përmirësimi i cilësisë së të dhënave për depozituesit dhe depozitat e siguruar.
	Zhvillimi i sistemit IT për modulën e kryerjes së procesit të kompensimit.
	Zhvillimi i planeve të punës për bashkëpunimin me Bankat Agjente në rast të një ngjarje sigurimi.
	Identifikimi dhe përzgjedhja paraprake e partnerëve mbështetës për procesin e kompensimit.
	Përcaktimi i metodologjisë për përlllogaritjen paraprake të kostos së procesit të kompensimit në rast të një ngjarje sigurimi.
	Rishikim dhe përmirësim i kuadrit ligjor dhe rregullator të nevojshëm për kryerjen e procesit të kompensimit.
<p>Kontributi për një regjim efektiv të ndërhyrjes së jashtëzakonshme</p>	Ngritja e infrastrukturës së duhur në Agjenci për përgatitjen dhe vlerësimin e opinionëve për planet e NJ.
	Hartimi i metodës për vlerësimin paraprak të ekspozimit të fondit të kompensimit në rast të pjesëmarrjes në planin e NJ.
<p>Administrimi i shëndetshëm i fondeve të kompensimit të depozitave dhe NJ, sigurimi i burimeve te përshtatshme për financimin e tyre.</p>	Ruajtja e treguesve të performancës financiare përkundrejt buxhetit të miratuar. (varianca 5%)
	Vlerësimi në vazhdimësi i nivelit të fondeve të kompensimit të depozitave dhe plotësimit në kohë të nevojave për likuiditet në rast të një ngjarje kompensimi nëpërmjet një sistemi paralajmërimi të hershëm.
	Hartimi i metodologjisë së vlerësimit të kostos të administrimit të fondeve të kompensimit të depozitave dhe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
	Përmirësimi i metodës së administrimit të rreziqeve lidhur me investimet dhe portofolin e letrave me vlerë të investuara.



<p>Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit dhe besimit të publikut ndaj skemës së sigurimit të depozitave</p>	<p>Të vijojë të nxisë edukimin financiar të publikut në vend nëpërmjet pjesëmarrjes së Agjencisë në programet e edukimit financiar ndërinstytucional.</p>
	<p>Të vijojë rritjen e komunikimit me grupet e targetuara për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për Agjencinë dhe rolin e saj, veçanërisht në një ngjarje sigurimi.</p>
	<p>Të rrisë transparencën dhe llogaridhënien në informimin e publikut dhe grupet e tjera të interesit lidhur me rolin, veprimtarinë dhe vendimmarrjen e Agjencisë për sigurimin e depozitave dhe rolin e saj, veçanërisht në një ngjarje sigurimi.</p>
	<p>Të vlerësojë në vazhdimësi efektivitetin e strategjisë së komunikimit.</p>
<p>Vlerësim i efektivitetit të skemës së sigurimit të depozitave</p>	<p>Vlerësimi i përshtatshmërisë së treguesve financiarë të skemës së sigurimit të depozitave sipas standardeve përkatëse të IADI/EFDI</p>
	<p>Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës me Parimet Baze për një Sistem Efektiv të Sigurimit të Depozitave.</p>


Objektivi Strategjik: Gatishmëria operationale e Agjencisë për kompensim

Iniciativat strategjike

- Përmirësimi dhe rritja e gatishmërisë së infrastrukturës teknologjike lidhur me sistemin e raportimit.

Plani vijon të ketë një objektiv strategjik të rëndësishëm për realizimin e mandatit të Agjencisë, përmirësimin dhe rritjen e gatishmërisë së infrastrukturës teknologjike. Agjencia gjatë këtij trevjeçari synon të rrisë dhe forcojë gatishmërinë operationale si dhe të gjejë metoda për rritjen e ekspertizës dhe aftësive të stafit. Efektiviteti i operationeve dhe proceseve është thelbësor për të përmbushur detyrat e mandatit të institucionit.

Në tre vitet në vijim, Agjencia do të forcojë shkallën e gatishmërisë nëpërmjet simulimeve të sistemit me anë të të cilave do të mund të identifikojë mundësitë për forcimin dhe përmirësimin e proceseve apo infrastrukturës së saj.



- Zhvillimi i sistemit IT për modulën e kryerjes së procesit të kompensimit.

Kryerja e procesit të kompensimit brenda afateve ligjore kërkon ngritjen dhe testimin e infrastrukturës së nevojshme që mbështet këtë proces dhe bashkërendon punën me aktorë të jashtëm që janë pjesë e tij. Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë i krijon Agjencisë mundësitë për të zhvilluar zgjidhje efektive informatike të cilat e mbështesin atë në përmbushjen e mandatit të saj.


Aktualisht zhvillimi i sistemit IT (SIRK) për modulën e kryerjes së procesit të kompensimit është pjesë e objektivave të planit strategjik të Agjencisë për tre vitet në vijim. Ky sistem do të mundësojë automatizimin e marrëdhënies me Bankën Agjente për pagesën e depozituesve dhe ankimimet në lidhje me to. Nëpërmjet sistemit do të realizohet gjurmimi në kohë reale i pagesave të depozituesve dhe raportimi për kryerjen e tyre në mënyrë që të kemi një proces të saktë dhe të shpejtë kompensimi.

- Përmirësimi i cilësisë së të dhënave për depozituesit dhe depozitat e siguruar.

Agjencia ka vlerësuar vazhdimisht se treguesi i cilësisë së të dhënave të depozituesve është thelbësor për të përmbushur mandatin ligjor në rast të një ngjarje sigurimi. Duke mbajtur në vëmendje rëndësinë që ka kjo çështje, Agjencia për tre vitet e ardhshme, do të vijojë të punojë intensivisht me subjektet anëtare të skemës, të cilët kanë detyrimin ligjor për mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave të depozituesve dhe depozitave në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor e rregullativ në fuqi.

Pavarësisht se ka përmirësim në disa kategori të të dhënave të depozituesve, vazhdon të mbetet sfida për Agjencinë adresimi i problemit të mungesës së numrit personal në këto të dhëna dhe zgjidhja e tij nga subjektet anëtare.

Për tre vitet e ardhshme, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të këtyre të dhënave Agjencia synon të hartojë dhe verë në zbatim “Platformën e re strategjike të përmirësimit të cilësisë së të dhënave për depozitat dhe depozituesit”.




Kjo platforme strategjike synon qe nëpërmjet konsultimeve me subjektet e siguruar të përcaktojë për secilën bankë apo shkk, tregues të matshëm për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të shoqëruar me afate kohore të përcaktuara për t'u plotësuar nga ana e tyre, si dhe do të mundësojë monitorimin e përmirësimit të këtyre treguesve nga ana e Agjencisë.

- Zhvillimi i planeve të punës për bashkëpunimin me Bankat Agjente në rast të një ngjarje sigurimi

Agjencia e Sigurimit te Depozitave ka objektiv ligjor kryerjen e saktë dhe të shpejtë të kompensimit të depozitave në një rast ngjarje sigurimi. Për realizimin e këtij procesi, Agjencia bashkëpunon me Bankat Agjente të përzgjedhura në listën paraprake në veprimtarinë e saj të përditshme. Gjatë kësaj periudhe tre vjeçare, Agjencia do të hartojë plane pune në bashkëpunim me Bankat Agjente, ku do të parashikohen veprimtaritë përgatitore për trajnimin dhe testimin e kapaciteteve operacionale të tyre, me qëllim që të sigurohet gadishmëria e shërbimit të pagesës së depozitave në rast të ndodhjes së një ngjarje sigurimi.

Këto plane konsiderohen të rëndësishme pasi nëpërmjet tyre do të kryhet evidentimi i personave përgjegjës, si dhe caktimi i personave të kontaktit që do të bashkëpunojnë me Agjencinë në një rast ngjarje kompensimi. Pjesë e planit të punës do të jetë përgatitja profesionale e tyre nga Agjencia, simulimi i përbashkët si edhe marrja e opinioneve të vlefshme sesi mund të përmirësohet më tej ky proces.

Gjithashtu, ky bashkëpunim është i rëndësishëm për të përshtatur infrastrukturën e Bankave Agjente, si në lidhje me përditësimin e sistemeve të tyre informatike, me qëllim që të jenë në gjendje të ofrojnë mundësinë e procesimit të pagesave në momentin e paraqitjes së depozituesit pranë sportelit të bankës, ashtu edhe në zhvillimin dhe rritjen e vazhdueshme profesionale të punonjësve të tyre në mënyrë që t'i përgjigjen në mënyrë efektive dhe të menjëhershme kërkesave të Agjencisë në rast të një ngjarje kompensimi.



- Identifikimi dhe përzgjedhja paraprake e partnerëve mbështetës për procesin e kompensimit.


Në rast të një ngjarje sigurimi, Agjencia e Sigurimit të Depozitave mund të bashkëpunojë me partnerë të tjerë mbështetës për realizimin në kohë dhe me efektivitet të procesit të kompensimit. Këto subjekte ndihmojnë në veprimtarinë e Agjencisë për realizimin e procesit të kompensimit, duke ofruar shërbime mbështetëse në fusha të ndryshme si: shërbime dhe mirëmbajtje të platformës elektronike, shërbime auditimi, shërbime kontabiliteti, shërbime ligjore, qendër telefonike (call center) etj. Agjencia do të identifikojë gjatë veprimtarisë së saj të përditshme subjektet mbështetëse të cilët ofrojnë shërbimet e nevojshme dhe që plotësojnë nevojat e saj në një rast kompensimi.

Gjatë kësaj periudhe tre vjeçare, Agjencia synon të organizojë simulime të një ngjarje kompensimi, të cilat do të shërbejnë për identifikimin e subjekteve mbështetës të nevojshëm për kryerjen e një procesi kompensimi të shpejtë dhe në kohën e duhur. Gjithashtu, Agjencia do të vlerësojë kategoritë e subjekteve që kanë rol të rëndësishëm në realizimin me sukses të procesit të kompensimit, të cilët duhet të përzgjidhen gjatë veprimtarisë së përditshme të saj.

Përveç sa më sipër, pas identifikimit dhe përzgjedhjes së subjekteve mbështetës të nevojshëm, personeli i këtyre subjekteve do të përgatitet nga Agjencia në vazhdimësi mbi rolin e tyre specifik në kryerjen e procesit të kompensimit. Kjo do të shmangte vonesat e panevojshme në rast të një procesi kompensimi, si dhe do të garantonte kualifikimin profesional të këtyre subjekteve sipas udhëzimeve të Agjencisë dhe veçorive të skemës së sigurimit të depozitave.

- Përcaktimi i metodologjisë për përlllogaritjen paraprake të kostos së procesit të kompensimit në rast të një ngjarje sigurimi.

Në përmbushje të objektivit strategjik të sigurimit dhe forcimit të gatishmërisë operacionale, Agjencia ka hartuar dhe miratuar manualin e planit të veprimeve të procesit të kompensimit i cili përshkruan veprimet që çdo sektor duhet të ndjekë për të realizuar funksionet për të cilat është përgjegjës. Ky manual veprimi, i cili është në përmirësim të vazhdueshëm, do të testohet gjatë simulimeve të ndryshme teknike dhe të përgjithshme që do të kryhen nga Agjencia. Përveç planit të



veprimeve të çdo njësie organizative të Agjencisë, vlerësohet që ky manual do të përmbajë gjithashtu edhe një metodologji e cila të përlllogarisë një kosto të parashikuar për të kryer këto veprime që çojnë në përmbushjen me sukses të procesit të kompensimit.


Metodologjia në fjalë, e cila synohet të përgatitet dhe të zbatohet në periudhën që planifikojmë, ka si qëllim të ndërlikohet listën e të gjitha veprimeve që nevojiten për të përmbushur këtë proces me elementet e kostos që evidentohen për secilin veprim si dhe të përlllogarisë koston analitike përkatëse të tyre, përfshirë edhe përlllogaritjen e kostos totale të Agjencisë për procesin e kompensimit.

- Rishikim dhe përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator të nevojshëm për kryerjen e procesit të kompensimit.

Në kushtet e ndryshimit të vazhdueshëm të sistemit bankar dhe financiar lind domosdoshmëria për përshtatjen e kërkesave rregullatore të skemës së sigurimit të depozitave me zhvillimet e reja. Kërkesat për rishikimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor me qëllim kryerjen e procesit të kompensimit, identifikohen nëpërmjet proceseve të vlerësimit të përputhshmërisë së veprimtarisë të Agjencisë me parimet themelore të skemave të sigurimit të depozitave, të simulimit, çështjeve që dalin nga praktika e zbatimit të kuadrit ligjor gjatë verifikimeve në subjektet anëtare të skemës, si dhe nga shkëmbimi i eksperiencës me skemat homologe.

Objektivi kryesor i punës për identifikimin e ndryshimeve të akteve në fuqi do të jetë ndër të tjera sigurimi i qartësisë ligjore për mbulimin ose përjashtimin nga sigurimi, shmangia e pengesave për përlllogaritjen e shpejtë dhe të saktë të shumës së kompensimit, si dhe mbështetja me aktet e duhura për koordinimin e vazhdueshëm me subjektet e skemës, bankat agjente dhe institucionet e rjetit të sigurisë financiare.

Përveç rishikimit të akteve në fuqi, synohet të hartohen projektakte të reja, të cilat do të sigurojnë gatishmërinë operacionale të sektorëve të Agjencisë në rast ngjarjeje sigurimi. Nevoja për identifikimin e ndryshimeve ligjore dhe nënligjore, do të marrë për bazë rekomandimet që mund të rezultojnë nga puna dhe analiza e sektorëve të Agjencisë në bashkëpunim me grupet e interesit.



Objektivi Strategjik: Kontributi për një regjim efektiv të ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Iniciativat strategjike


- Ngritja e infrastrukturës së duhur në Agjenci për përgatitjen dhe vlerësimin e opinioneve për planet e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Në dhjetor të vitit 2016, nën koordinimin e Bankës së Shqipërisë dhe institucioneve ndërkombëtare financiare u miratua paketa e re ligjore për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë. Agjencisë i ngarkohet një detyrë më shumë: të jetë administrator i fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe kontribues me fondin e kompensimit të depozitave në veprimtarinë e rimëkëmbjes apo ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Bazuar në Ligjin Nr. 133/2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme merr opinionin e Agjencisë për planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në rastet kur kërkohet përfshirja e Agjencisë.

Agjencia do të ngrejë infrastrukturën e nevojshme, e cila do të mundësojë ndjekjen e procesit të përgatitjes së këtij opinionin, ku përfshihen llogaritjet e kostove sipas rastit, deri në aprovimin dhe përcjelljen e tij në ANJ. Me infrastrukturë kuptojmë gjithashtu caktimin e strukturave organizative përgjegjëse që do të merren me secilin nga veprimet që do të ndiqen në përgatitjen e opinioneve për ANJ.

- Hartimi i metodës për vlerësimin paraprak të ekspozimit të fondit të kompensimit në rast të pjesëmarrjes në planin e NJ.

Në përputhje me nenin 78, pika 1 të ligjit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, mund të vendosë për përdorimin e fondit të kompensimit të depozitave në banka gjatë kryerjes së ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Shuma e kërkuar nga ANJ duhet: a) të jete me e vogel se shuma qe do te kishte përdorur Agjencia ne rast kompensimi dhe b) nuk duhet të jetë më e madhe se 50% e fondit të kompensimit të depozitave në banka.



Agjencia, në funksion të përgatitjes për t'ju nënshtruar një regjimi efektiv të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, do të përcaktojë një metodologji për përlogaritjen e shumës maksimale sipas kushteve ligjore, në rast të përdorimit të fondit të kompensimit të bankave. Kjo metodologji do të ndërtohet mbi të dhëna sasiore lidhur me gjendjen fondit të kompensimit të depozitave dhe shumën e depozitave të siguruar si dhe të dhëna të tjera cilësore të cilat do të synojnë mbrojtjen e depozituesve edhe në rastet pas përdorimit të fondit të kompensimit nga ANJ.

Objektivi strategjik: Administrimi i shëndetshëm i fondeve të kompensimit të depozitave dhe NJ, sigurimi i burimeve të përshtatshme për financimin e tyre.


Iniciativat strategjike

- Ruajtja e treguesve të performancës financiare përkundrejt buxhetit të miratuar.

Menaxhimin efektiv i mjeteve financiare të Agjencisë është një nga drejtimet kryesore të mirëadministrimit të skemës së sigurimit të depozitave. Angazhimi dhe bashkëpunimi i strukturave që përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë si Sektori i Financës dhe Investimeve, Sektori i Analizës së Rrezikut dhe strukturave vendimmarrëse si Komiteti i Investimeve për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin më me efektivitet të rreziqeve financiare të mundshme të portofolit të Agjencisë, do të jetë një nga prioritetet në arritjen e objektivave strategjike të saj. Rëndësi të veçantë merr në këtë aspekt respektimi i moderuar i Politikës së Investimit për çdonjërin nga fondet të anëtarëve të skemës së sigurimit të depozitave, sipas transheve dhe monedhës së investuar.

Një nga faktorët të identifikuar që do t'i mundësojë Agjencisë përmbushjen e këtij faktori me sukses të mandatit të saj është treguesi i realizimit të buxhetit, i cili synohet të luhetet në variancën $\pm 5\%$. Arritja e këtij treguesi kërkon angazhimin profesional të të gjitha strukturave në Agjenci për të mundësuar :

a. Një planifikim sa më real të projekteve në mbështetje të objektivave strategjike.



b. Bashkërendim dhe bashkëpunim midis tyre për realizimin e projekteve strategjike.

c. Monitorim i administrimit të fondeve dhe burimeve të tjera të saj.

Për të realizuar këtë objektiv, Agjencia do të vazhdojë të planifikojë treguesit financiarë të performancës dhe të rishikojë në mënyrë të vazhdueshme procesin e planifikimit të buxhetit, i cili mundëson përfshirjen aktive të të gjithë strukturave.


- Vlerësimi në vazhdimësi i nivelit të fondeve të kompensimit të depozitave dhe plotësimit në kohë të nevojave për likuiditet në rast të një ngjarjeje kompensimi nëpërmjet një sistemi paralajmërimi të hershëm.

Aktualisht Sektori i Anlizës së Riskut (SAR) zbaton një metodologji e cila konsiston në përpunimin e treguesve financiarë për secilën bankë të cilët përfitohen nga Autoriteti Mbikëqyrës. Përpunimi i treguesve bëhet me frekuencë tremujore me qëllim identifikimin e bankave me performancë financiare relative më të dobët. Qëllimi i aplikimit të kësaj metodologjie përveç njohjes në kohë të shpërndarjes së rrezikut në sistemin bankar ka edhe qëllimin e minimizimit të rrezikut të likuiditetit nëpërmjet përshtatjes së investimeve të mjeteve financiare në portofolet e Agjencisë.

Për të përmirësuar dhe plotësuar këtë metodë, do të aplikohen procese e paralajmëruese për ato banka të cilat rezultojnë me performancë relative më të dobët me qëllim që të parashikohet një ngjarje e mundshme sigurimi sa më herët. Në varësi të rezultateve që gjenerohen nga kjo metodë e përmirësuar do të përshtatet vendimmarrja për investimin apo jo të fondeve në portofolin e Agjencisë.

- Hartimi i metodologjisë së vlerësimit të kostos së administrimit të fondeve të kompensimit të depozitave dhe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Sipas rregullores “Për FNJ dhe procedurat për administrimin e tij”, miratuar nga Banka e Shqipërisë, shpenzimet vjetore të fondit përfshijnë vlerën e kostove të drejtpërdrejta dhe kostove të tërthorta. Kostot e veçueshme, që lidhen drejtpërdrejt me administrimin e fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, janë ato të tilla si komisionet bankare etj. Ndërsa kostot e tërthorta përfshijnë



kohën, punën dhe shpenzimet që kryen Agjencia për investimin dhe mbajtjen e këtyre fondeve. Këto kosto të Agjencisë, do të ndahen sipas fondeve në mënyrë proporcionale me numrin e transaksioneve të kryera për investimin e mjeteve të secilit fond.

Agjencia brenda vitit 2018 do të krijojë metodologjinë sipas se cilës ts përcaktohen elementet e kostos se administrimit te fondeve, perlllogariten këto kosto të mblidhen dhe më tej të shperndahen/ri-alokohen per secilin fond, ne perputhje me rregulloren “Për FNJ dhe procedurat për administrimin e tij” në fillim të 2019.


- Përmirësimi i metodës së administrimit të rreziqeve lidhur me investimet dhe portofolin e letrave me vlerë të investuara.

Sektori i analizës së riskut në Agjenci monitoron portofolin e investuar me qëllim respektimin e kriterëve dhe kufizimeve të politikës së administrimit të mjeteve financiare. Po ashtu ky monitorim bëhet edhe për të vlerësuar përmbushjen e vendimeve të komitetit të investimeve. Në këtë mënyrë Agjencia vlerëson nëse investimet janë kryer në funksion të mandatit ligjor të Agjencisë.

Në këtë plan strategjik, Agjencia planifikon të ngrejë një metodologji të plotë për monitorimin e rreziqeve përpara faktit të investimit, duke synuar që burimet e informacionit për monitorimin të jenë të ndara nga strukturat ekzekutuese, mbështetur në parimin e kontrollit të “katër syve”. Në këtë mënyrë, monitorimi do të sigurojë që investimet janë kryer në përputhje me vendimet e Komitetit të Investimeve dhe politikën e administrimit të mjeteve financiare.

Objektivi strategjik: Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit dhe besimit të publikut ndaj skemës së sigurimit të depozitave

Agjencia do të vijojë të punojë për rritjen e besimit të publikut në përputhje me mandatin e saj për të mbrojtur depozituesit dhe siguruar ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, nëpërmjet përdorimit të mekanizmave të ndërgjegjësimit të publikut për skemën e sigurimit të depozitave si edhe mbështetjes së politikave të edukimit financiar në vend.



Iniciativat strategjike

- Të vijojë rritjen e komunikimit me grupet e targetuara për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për rolin e Agjencisë.


Sondazhet e fundit të kryer nga ASD mbi nivelin e ndërgjegjësimit të publikut dëshmuar për një rritje të nivelit të njohurive të publikut lidhur me skemën e sigurimit të depozitave në Shqipëri.

Nga rezultatet e marra gjatë viteve, Agjencia vlerëson se duhet të punohet akoma më shumë në drejtim të përafrimit me eksperiencat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë. Për përmirësimin e mëtejshëm të iniciativave të ndërmarra gjatë viteve të fundit, në zbatim të Strategjisë së Ndërgjegjësimit të Publikut, do të përafrohet metodologjia me karakteristikat e grupeve të targetuara që kanë rezultuar më pak të vetëdijshëm mbi skemën sigurimit, përfitimet dhe kufizimet e saj.

- Të rrisë transparencën dhe llogaridhënien në informimin e publikut dhe grupet e tjera të interesit lidhur me rolin, veprimtarinë dhe vendimmarrjen e Agjencisë për sigurimin e depozitave dhe rolin e saj, veçanërisht në një ngjarje sigurimi.

Vlerësimi dhe rishikimi i programeve ekzistuese të edukimit dhe informimit do të synojë që publiku të informohet në mënyrë të vazhdueshme dhe me transparencë lidhur me skemën e sigurimit të depozitave dhe në veçanti sa i takon rolin dhe funksionin e Agjencisë në rastin e një ngjarje sigurimi.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave do të vijojë të angazhohet me përgjegjshmëri dhe transparencë në procesin e llogaridhënies në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Autoritetin Mbikëqyrës. Ky angazhim do të realizohet gjithashtu nëpërmjet publikimit të vendimmarrjes, akteve rregullative për anëtarët e skemës dhe veprimtarinë e Agjencisë, materialeve informuese dhe dokumenteve raportuese në faqen e internetit të Agjencisë.



- Të vijojë të nxisë edukimin financiar të publikut në vend nëpërmjet pjesëmarrjes së Agjencisë në programet e edukimit financiar nderinsitucional në nivel kombëtar.

Edukimi financiar i publikut dhe promovimi i skemës me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për rolin dhe funksionin e Agjencise do të jenë prioritetet që do të orientojnë punën dhe përcaktimin e iniciativave strategjike përgjatë viteve në vijim. Nisur nga kjo, ASD është e angazhuar që në periudhën e planifikuar të rrisë pjesëmarrjen e saj në programet e edukimit financiar nderinsitucional. Për këtë qëllim do të synohet forcimi i bashkëpunimit me institucionet që përbëjnë rrjetin e sigurisë financiare në vend për të siguruar përputhshmërinë e informacionit që përcillet në publik.

- Të vlerësojë në vazhdimësi efektivitetin e strategjisë së komunikimit.


Për të vlerësuar në vazhdimësi efektivitetin e strategjisë së komunikimit, me qëllim përmirësimin e saj, Agjencia do të vazhdojë (i) të kryejë studime anketuese periodike me synim matjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me skemën e sigurimit dhe Agjencinë (ii) të rishikojë projektet konkrete për të transmetuar mesazhet dhe informacionin e nevojshëm, në mënyrë të saktë, të kuptueshëm dhe në kohë nëpërmjet kanaleve të saj të komunikimit, si në veprimtarinë e përditshme ashtu edhe në rast ngjarje sigurimi.

Objektivi strategjik: Vlerësim i efektivitetit të skemës së sigurimit të depozitave.

Iniciativat strategjike

- Vlerësimi i përshtatshmërisë së treguesve të skemës së sigurimit të depozitave sipas standardeve përkatës të IADI/EFDI

Agjencia e Sigurimit të Depozitave në cilësinë e anëtares të Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI) dhe të Forumit Evropian të Siguruesve të Depozitave (EFDI) duhet të kryejë vlerësimin e përshtatshmërisë të veprimtarisë së saj me parimet themelore, udhëzimet dhe standardet ndërkombëtare si në drejtim të menaxhimit të përgjithshëm, po kështu edhe të analizës financiare.



Agjencia do të zbatojë në vijimësi detyrimin për të vlerësuar çdo pesë vjet, përputhshmërinë e niveleve maksimale të mbulimit me kushtet ekonomike dhe sociale të Republikës së Shqipërisë dhe standardet ndërkombëtare të sigurimit të depozitave. Në veçanti, Agjencia do të vazhdojë të ndjekë ecurinë e raportit të mbulimit të depozitave të siguruara me fondet e saj, si dhe të përputhshmërisë të nivelit të synuar të këtyre fondeve me standardet e përcaktuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave (IADI) duke synuar ruajtjen dhe forcimin e aftësisë paguese të skemës.


- Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës me parimet bazë për një sistem efektiv të sigurimit të depozitave.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave, në cilësinë e anëtares të Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave, ka kryer dy vlerësime të përputhshmërisë të skemës me parimet themelore për sistemet efektive të sigurimit të depozitave. Në kushtet kur parimet bazë janë rishikuar, njëri nga objektivat për periudhën 2018 – 2020 mbetet rivlerësimi i efektivitetit të Agjencisë në veçanti dhe i skemës në tërësi. Parimet themelore të rishikuara vazhdojnë të luajnë rolin e një standardi gjithëpërfshirës për themelimin dhe përmirësimin e sistemeve të sigurimit të depozitave.

Procesi i vlerësimit të përputhshmërisë konsiderohet një mjet i domosdoshëm për identifikimin e prioriteteve dhe sfidave të Agjencisë. Rezultatet e këtij procesi përbëjnë bazën e masave që duhen zbatuar nga institucioni ynë, anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare dhe subjektet anëtare të skemës për përmirësimin strukturor, institucional dhe ligjor të skemës së sigurimit të depozitave.

Bashkëpunimi dhe përfshirja e ekspertëve të brendshëm dhe të huaj garanton shkëmbimin e përvojës dhe dijeve të përfituara nga konferencat, forumet dhe punët kërkimore më të fundit të kryera në këtë fushë.

Vlerësimi i përputhshmërisë me parimet bazë merr një vlerë të shtuar në kushtet, kur Agjencia është përfshirë në procesin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka. Për këtë qëllim ky proces vlerësimi gjithëpërfshirës do të synojë, ndër të tjera, të ketë si objekt edhe këtë funksion të ri ligjor të Agjencisë dhe ndërveprimin e saj me Bankën e Shqipërisë.




Prioriteti Strategjik II

Menaxhimi Kapitalit Njerëzor

Prioriteti strategjik për menaxhimin e kapitalit njerëzor përbën një drejtim të ri strategjik të rëndësishëm për përmbushjen e objektivave dhe iniciativave të planit strategjik të Agjencisë për vitin 2018-2020. Ky prioritet do të jetë edhe për vitet në vijim një sfidë për Agjencinë dhe përgjegjësi e ndarë midis njësisë së Burimeve Njerëzore dhe drejtuesve të të gjitha niveleve në Agjenci. Agjencia është një institucion unik në funksionin e saj në vend, për këtë arsye do të vijojë të investojë në kapitalin e burimeve të saj njerëzore dhe do të hartojë strategjinë e zhvillimit të burimeve njerëzore me qëllim tërheqjen, ruajtjen, nxitjen dhe angazhimin e talenteve, për të siguruar drejtim efektiv, administrim të suksesshëm, me synimin që të krijojë një institucion mësimi dhe edukimi profesional.

Objektivi	Iniciativat Kryesore
<p>Krijimi i mjedisit të përshtatshëm për zhvillimin profesional të punonjësve në përputhje me vizionin dhe misionin e Agjencisë.</p>	<p>Hartimi i dokumentit të strategjisë së zhvillimit të burimeve njerëzore.</p> <p>Identifikimi i nevojave për zhvillimin dhe rritjen e vazhdueshme profesionale të punonjësve.</p> <p>Hartimi i programeve të trajnimit dhe aplikimi i metodave të edukimit që sigurojnë përftim sa më efektiv të njohurive të reja nga punonjësit si edhe transferimin e tyre midis punonjësve.</p>
<p>Motivimi dhe ruajtja e personelit ekzistues si dhe tërheqja e talenteve të reja.</p>	<p>Promovimi i punonjësve bazuar në sistemin e performancës.</p> <p>Tërheqja e talenteve të reja nëpërmjet nxitjes së sistemit të praktikave studentore në ASD dhe bashkëpunimit me universitete vendase.</p>



Objektivi strategjik: Krijimi i mjedisit të përshtatshëm për zhvillimin profesional të punonjësve në përputhje me vizionin dhe misionin e Agjencisë.

Iniciativat strategjike


- Hartimi i strategjisë për zhvillimin e burimeve njerëzore.

Agjencia konsideron burimet njerëzore si një nga faktorët më të rëndësishëm në veprimtarinë e përditshme dhe në arritjen e qëllimit të saj. Për këtë arsye Agjencia këtë tre vjeçar synon ndërtimin e një strategjie për zhvillimin e burimeve njerëzore e cila do të ndihmojë në menaxhimin sa më optimal të kapaciteteve të stafit dhe në orientimin sa më eficient të politikave të zhvillimit të tij.

Strategjia e Burimeve Njerëzore do të synojë të japë vizionin, misionin, parimet dhe konceptet themelore për politikën, planifikimin dhe procedurat që mbështesin ciklin jetësor të burimeve njerëzore në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave. Kjo strategji do të ketë si objektivi zhvillimin dhe ruajtjen e një mjedisi pune që ngre besimin tek punonjësit, motivimin dhe kënaqësinë në punë, si dhe përmirësimin dhe ruajtjen e mirëqenies sociale të punonjësve.

- Identifikimi i nevojave për zhvillimin dhe rritjen e vazhdueshme profesionale të punonjësve.

Duke vlerësuar si prioritet kualifikimin profesional të burimeve njerëzore, Agjencia do të mundësojë hartimin e një programi për identifikimin e nevojave për trajnime të vazhdueshme dhe do të hartojë politika stimuluese për personelin me qëllim rritjen e kualifikimeve profesionale në përputhje me misionin dhe objektivat strategjike të saj. Këto trajnime do të kenë si synim zhvillimin e aftësive të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të secilit, si dhe shkëmbimin e njohurive dhe eksperiencës me agjencitë homologe të sigurimit të depozitave. Në kuadër të bashkëpunimit dhe shkëmbimit e përfitimit të përvojave më të mira, punonjësit e Agjencisë do të vazhdojnë të marrin pjesë në konferenca dhe trajnime vjetore të zhvilluara nga institucione ndërkombëtare si IADI dhe EFDI, apo trajnime të organizuara nga institucione të tjera.



- Hartimi i programeve të trajnimit dhe aplikimi i metodave të edukimit që sigurojnë përftim sa më efektiv të njohurive të reja nga punonjësit, si edhe transferimin e tyre midis punonjësve.

Agjencia do të fokusohet në menaxhimin e aktiviteteve që lidhen me identifikimin e nevojave të personelit, përmirësimin e aftësive profesionale nëpërmjet realizimit të trajnimeve në përshtatje me nevojat profesionale të identifikuara të vendit të punës. Këtë 3 vjeçar e në vijim parashikohet të zhvillohen anketime të stafit të cilat do të kenë si qëllim matjen e nivelit të kënaqësisë së stafit dhe identifikimin e objektivave profesionale të tyre.


Gjithashtu, vlerësohet se transferimi i njohurive ndërmjet personelit të Agjencisë është një vlerë e shtuar në drejtim të rritjes së kapaciteteve. Për këtë qëllim, gjate këtij 3 vjeçari do të synohet ngritja e një mekanizimi, sipas modelit “*trajnim i trajnuesve*”, i cili do të identifikojë dhe përgatisë pjesëtarë të personelit me njohuri operacionale të nivelit të lartë dhe aftësi pedagogjike për të shërbyer si trajnues për tematika të karakterit operacional të identifikuara nga strukturat e Agjencisë. Në periudhën tre-vjeçare të Planit Strategjik 2018-2020, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës së përfituar me anëtarët e tjerë të stafit të agjencisë, në përfundim të çdo trajnimi, gjithashtu do të synohet që punonjësit të vënë në dispozicion njohuritë e përfituara dhe materialet e përdorura.

Objektivi strategjik: Motivimi dhe ruajtja e personelit ekzistues si dhe tërheqja e talenteve të reja.

Iniciativat strategjike

- Promovimi i punonjësve bazuar në sistemin e performancës.


Agjencia zbaton sistemin e performancës në punë të punonjësve në bazë të kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi. Duke filluar nga viti 2018, Agjencia parashikon të implementojë metodën e vlerësimit të performancës bazuar në tregues sasiore. Treguesit sasiore do të shërbejnë si pika orientimi për pritshmëritë e Agjencisë ndaj punonjësve të saj dhe do ta bëjnë procesin e vlerësimit të performancës më të efektshëm dhe më të drejtë duke lidhur objektivat personale të punonjësve me



objektivat e Agjencisë. Në këtë mënyrë realizimi i objektivave të pritshëm do të jetë më lehtësisht i matshëm.

- Tërheqja e talenteve të reja

Agjencia do të synojë të tërheqë talentet e reja nëpërmjet bashkëpunimit me universitetet vendase për hartimin e programeve të përbashkëta me qëllim (i) përfshirjen e studentëve në punimet e Agjencisë me natyrë kërkimore shkencore (ii) nxitjen e praktikave mësimore për studentet në Agjenci. Agjencia do të vijojë të zbatojë politika për tërheqjen e talenteve të reja, si dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit ekzistues. me qëllim që të ketë gjithmonë personel të mirë përgatitur për përballimin e sfidave të mundshme.




Prioriteti Strategjik III

Zhvillim Strategjik i Partneritetit

Në hartimin e këtij Plani Strategjik u vlerësua se vendosja dhe zhvillimi i marrëdhënieve me institucionet partnere të Agjencisë, vendase dhe ndërkombëtare, do të jetë një faktor i rëndësishëm në përmbushjen e mandatit dhe realizimin me sukses të misionit të Agjencisë. Agjencia çmon se bashkëpunimi institucional dhe transparent me institucionet mbikëqyrëse e rregullatore, ato të hartimit dhe zhvillimit të politikave financiare e ekonomike, anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave, agjencitë homologe, etj., është një burim i cili duhet shfrytëzuar në maksimum me qëllim krijimin e një mjedisi sa më efikas nga pikëpamja operationale dhe sa më të sigurtë nga këndvështrimi i besimit të depozituesve dhe publikut në sistemin financiar në vend.

Për këtë qëllim, në periudhën tre-vjeçare synojmë ti shtojmë përpjekjet tona në drejtim të përforcimit të angazhimit me partnerët strategjikë duke promovuar praktikat më të mira të bashkëpunimit institucional.

Objektivi	Iniciativat Kryesore
Përforcimi i marrëdhënieve me institucionet e GKSF.	Forcimi i bashkëpunimit dhe rishikimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me BSH përfshirë zbatimin e detyrimeve ligjore të NJ.
Zhvillimi i marrëdhënieve me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave dhe institucione të tjerë të sektorit.	Intensifikimi i marrëdhënieve me subjektet e skemës. Nënshkrimi i një marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën Shqiptare të Bankave
Intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me institucione homologe dhe organizata ndërkombëtare në të cilat ASD aderon.	Bashkëpunimi ndërkombëtar me institucionet homologe. Bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të anëtarësisë në EFDI dhe IADI.




Objektivi strategjik: Përforcimi i marrëdhënieve me institucionet e GKSF

Agjencia e Sigurimit të Depozitave është anëtare *de facto* e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF), i cili përbëhet nga Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Bashkëpunimi i anëtarëve të GKSF është institucionalizuar përmes një Memorandumi Bashkëpunimi nënshkruar në mars 2014. Qëllimi i këtij Memorandumi është bashkëpunimi në drejtim të zhvillimit të sistemit financiar dhe parandalimit e administrimit të situatave të jashtëzakonshme në veprimtarinë e tregjeve dhe të subjekteve financiare që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, të cilat mund të kërcënojnë stabilitetin e sistemit financiar të vendit. Në këtë kuadër, Agjencia vlerëson se bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e rrjetit të sigurisë financiare në vend duhet të jetë në fokus të strategjisë së saj trevjeçare, me qëllim përmbushjen me sukses të mandatit dhe objektivave të saj publikë.

Iniciativat strategjike

- Forcimi i bashkëpunimit dhe rishikimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë përfshirë zbatimin e detyrimeve ligjore të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Për periudhën tre vjeçare, pjesë e këtij plani strategjik, do të vazhdojmë të bashkëpunojmë ngushtë me Bankën e Shqipërisë, duke patur në konsideratë rolin kyç të këtij institucioni si autoriteti përgjegjës rregullator dhe mbikëqyrës i sektorit bankar dhe financiar. Në kuadër të ndryshimeve që ka pësuar mandati ligjor i Agjencisë në vijim të përfshirjes në skemë të shoqërive të kursim kreditit dhe funksionit të shtuar për administrimin e fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, bashkëpunimi institucional me Bankën e Shqipërisë është zgjeruar dhe ka marrë dimensione të reja. Agjencia vlerëson si domosdoshmëri rishikimin e marrëveshjes ekzistuese të bashkëpunimit dhe planifikon të propozojë nënshkrimin e një marrëveshje të re gjithëpërfshirëse me Bankën e Shqipërisë, e cila të mbulojë të gjithë spektrin e marrëdhënieve institucionale në përmbushje të detyrimeve ligjore respektive. Marrëveshja do të synojë përcaktimin e mënyrave të bashkëpunimit dhe koordinimit e aktiviteteve përkatëse, veçanërisht në rast kompensimi ose në rastet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Agjencia synon që kjo marrëdhënie ndër institucionale të konkretizohet me hartimin e procedurave



operacionale përkatëse. Marrëveshja do të ndikojë në rritjen e efektivitetit të dy institucioneve në përmbushje të funksioneve ligjore të tyre.


Objektivi strategjik: Zhvillimi i marrëdhënieve me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave dhe institucione të tjerë të sektorit.

Iniciativat strategjike

- Intensifikimi i marrëdhënieve me subjektet e skemës.

Agjencia beson që menaxhimi me efektivitet i vetë subjekteve anëtare të skemës është i rëndësishëm për të arritur/realizuar objektivat e saj strategjike. Për këtë arsye, veprimtaria e Agjencisë bazohet në bashkëpunimin me subjektet anëtare si në drejtim të funksionit rregullator për mirëfunksionimin e skemës ashtu edhe në drejtim të bashkërendimit të aktiviteteve dhe përpjekjeve për krijimin e një mjedisi sa më të edukuar dhe mirë informuar. Duke vlerësuar maksimalisht se bashkëpunimi me anëtarët e skemës do të rezultojë në përfitime dypalëshe, në tre-vjeçarën 2018-2020 Agjencia do të synojë të përforcojë në vazhdimësi këtë marrëdhënie institucionale duke vendosur si prioritet (1) bashkëpunimin për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozituesve, si një element përcaktues në realizimin e një procesi kompensimi të shpejtë dhe të saktë; (2) edukimin dhe mirë informimin në kohë të punonjësve të subjekteve anëtare të skemës me të gjitha aktet rregullative ligjore dhe nënligjore të miratuara dhe vënë në zbatim nga Agjencia; (3) edukimin e klientëve (depozituesve) të subjekteve anëtare të skemës, në bashkëpunim dhe koordinim me këta të fundit, në lidhje me përfitimet dhe kufizimet që kanë depozituesit nga sigurimi i ofruar nga skema.

Përveç sa më lart, duke marrë në konsideratë anëtarësimin rishtazi në skemën e sigurimit të depozitave të Shoqërive të Kursim – Kreditit, Agjencia do t'i kushtojë vëmendje të veçantë intensifikimit të marrëdhënieve me këto institucione të mikro-financës, për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit tek punonjësit dhe depozituesit e tyre. Si pjesë e këtij angazhimi parashikohet rishikimi i materialeve informuese, testimi i njohurive të punonjësve mbi skemën dhe trajnimi në vijimësi i tyre.



- Nënshkrimi i një marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën Shqiptare të Bankave

Një nga elementët më të rëndësishëm të bashkëpunimit për ndërgjegjësimin mbi skemën është edhe bashkëpunimi me Shoqatën Shqiptare të Bankave. Vlerësohet se marrëdhënia e zhvilluar gjatë tre-vjeçarit të fundit ka qenë e frytshme dhe ka sjellë risi konkrete të tilla si, leksione të hapura në auditore, organizimi i debatit me studentë të universiteteve të ndryshme dhe pjesëmarrje në Javën Globale të Parasë të bashkërenduara me Bankën e Shqipërisë.

Bashkëpunimi i Agjencisë me Shoqatën Shqiptare të Bankave merr një rol të rëndësishëm themelore, kur bëhet fjalë për organizimin e aktiviteteve të cilat kanë për qëllim vjeljen e komenteve dhe opinionëve për rishikimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor të skemës, koordinimin e veprimeve të përbashkëta për një zbatim sa më të mirë të rekomandimeve nga verifikimet dhe nxitjen e përmirësimit të përgjithshëm të cilësisë së mbajtjes së të dhënave të depozituesve.


Për këtë qëllim synohet që gjatë tre viteve të ardhshme të nënshkruhet një marrëveshje bashkëpunimi. Kjo marrëveshje do të shërbejë për të krijuar kornizën brenda së cilës Shoqata Shqiptare e Bankave do të ketë një rol të rëndësishëm, jo vetëm në veprimtarinë e përditshme të skemës së sigurimit të depozitave, por edhe në simulimet që do të zhvillohen me bankat agjente, për bashkëveprimin e sektorit në rast ngjarjeje sigurimi.

Objektivi strategjik: Intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me institucione homologe dhe organizata ndërkombëtare në të cilat Agjencia është anëtare.

Iniciativat strategjike

- Bashkëpunimi ndërkombëtar me institucionet homologe.

Gjatë periudhës së planit Strategjik 2015-2017, Agjencia ka qenë mjaft e angazhuar në ngritjen dhe institucionalizimin e protokolleve të bashkëpunimit me agjenci homologe, veçanërisht me siguruesit e depozitave të rajonit. Ky bashkëpunim ka rezultuar i frytshëm në drejtim të shkëmbimit të informacioneve dhe njohurive në forumet e përbashkëta rajonale, duke marrë dhe në konsideratë ngjashmërinë institucionale dhe operacionale të agjencive homologe të rajonit.




Plani Strategjik 2018-2020 do të synojë, krahas kontributit në vazhdimësi në forumet rajonale, shtrirjen e këtij bashkëpunimi në një plan më të gjerë evropian. Agjencia gjatë kësaj periudhe do të konsiderojë lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritete të sigurimit të depozitave të atyre vendeve evropiane, industria bankare e të cilave është e pranishme përmes filialeve në sistemin bankar shqiptar. Këto marrëveshje do të synojnë të ofrojnë një vlerë të shtuar si në drejtim të shkëmbimit të informacioneve në rastet e ngjarjeve të sigurimit në institucionet bankare mëmë të anëtarëve të skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri, por gjithashtu edhe në drejtim të konsultimeve dhe bashkëpunimit për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* sa i takon disiplinës së sigurimit të depozitave, ndër të tjera.

- Bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të anëtarësisë në EFDI dhe IADI.

Agjencia është një nga anëtarët më të hershëm të organizatave ndërkombëtare të sigurimit të depozitave siç janë IADI¹ dhe EFDI². Anëtarësimi në këto organizata vlerësohet si faktor i një rëndësie strategjike sa i takon përfitimit nga vënia në zbatim e Parimeve Themelore për Skema Efektive të Sigurimit të Depozitave (IADI Core Principles), ashtu edhe nga ekspertiza dhe eksperiencia e institucioneve anëtare. Ashtu si dhe në tre-vjeçarin e kaluar, edhe në periudhën e Planit Strategjik 2018-2020, Agjencia do të vazhdojë të marrë pjesë në forumet ndërkombëtare të organizuara në kuadër të këtyre organizmave si dhe do të ofrojë kontributin e saj përmes pjesëmarrjes në komitetet përkatëse, grupet e punës si dhe nëpërmjet organizimit e mikpritjes së aktiviteteve të bashkërenduara. Gjithashtu, duke vlerësuar se në këtë Plan Strategjik është parashikuar të kryhet vlerësimi i përshtatshmërisë së treguesve financiarë të skemës së sigurimit të depozitave si dhe vlerësimi i efektivitetit të skemës sipas Parimeve Themelore, bashkëpunimi përmes përfshirjes së ekspertëve të brendshëm dhe përfitimit të asistencës teknike të ekspertëve të IADI dhe EFDI konsiderohet me rëndësi të veçantë, me qëllim realizimin me sukses të këtyre iniciativave strategjike.

¹ International Association of Deposit Insurers – Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave.

² European Forum of Deposit Insurers – Forumi Evropian i Siguruesve të Depozitave




Plani Financiar 2018 - 2020

Plani financiar është bazuar në analizën e treguesve financiarë në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditit, investimit të mjeteve financiare në përputhje me parimet e likuiditetit dhe sigurisë, si dhe realizimit të shpenzimeve dhe të ardhurave vjetore me një luhatje maksimale prej $\pm 5\%$. Këto parime do të zbatohen në vijimësi për planifikimin financiar në kuadër të kësaj strategjie.


Bazuar në rezultatet e periudhave të përfshira në planin e mëparshëm strategjik si edhe në projektet strategjike të propozuara nga strukturat e Agjencisë, në tre vitet e ardhshme parashikohet që:

- Të ardhurat nga primi i sigurimit të rriten çdo vit në masën 1%.
- Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të Agjencisë të rriten çdo vit në masën 2%.
- Shpenzimet korrente të ndryshojnë çdo vit në masën rreth 5%.
- Shpenzimet kapitale të ndryshojnë çdo vit në masën rreth 5%.

Tabela më poshtë jep planin financiar të Agjencisë të miratuar për vitin 2018, burimet financiare që duhen për të siguruar vijimësinë e planit strategjik gjatë këtij viti si edhe parashikimet financiare për vitet 2019 dhe 2020, të cilat kryesisht janë bazuar në iniciativat strategjike të Agjencisë gjatë periudhës së planifikuar, sipas një planifikimi të kujdesshëm mbështetur (i) në treguesit e mëparshëm të ecurisë së të ardhurave dhe shpenzimeve (ii) iniciativat prioritare strategjike në përmbushje të mandatit.




	Buxheti 2018	Buxheti 2019	Ndryshim i vjetor	Buxheti 2020	Ndryshimi vjetor
Të Ardhurat	4,085,949,000.00	4,135,462,980.00		4,185,645,189.60	
Nga Primet	3,220,500,000.00	3,252,705,000.00		3,285,232,050.00	
a) Fondi Banka	3,210,000,000.00	3,242,100,000.00	1%	3,274,521,000.00	1%
b) Fondi SHKK	10,500,000.00	10,605,000.00	1%	10,711,050.00	1%
Nga investimi i mjeteve financiare	865,449,000.00	882,757,980.00		900,413,139.60	
a) Fondi Banka	863,900,000.00	881,178,000.00	2%	898,801,560.00	2%
b) Fondi SHKK	1,549,000.00	1,579,980.00	2%	1,611,579.60	2%
Totali Shpenzimeve	192,388,260.00	197,746,423.00		217,685,119.15	
Shpenzimet Korrente	180,213,260.00	189,223,923.00	5%	198,685,119.15	5%
Shpenzimet Kapitale	12,175,000.00	8,522,500.00		19,000,000.00	
Aktive Afatgjata Materiale	12,175,000.00	8,522,500.00		2,000,000.00	
Aktive Afatgjata JoMateriale	-			17,000,000.00	



Shënime shpjeguese:

- Planifikimi i rritjes së të ardhurave nga primet është bazuar në trendin e rritjes të moderuar të depozitave të siguruar në subjektet anëtare të skemës së sigurimit në periudhat e mëparshme.
- Planifikimi i rritjes së të ardhurave nga investimet e mjeteve financiare është bazuar në metodën e variancës historike dhe rezultatet nga devijimi standard i të dhënave të realizimit të buxhetit në raport me planin në vitet e kaluara.
- Planifikimi për shpenzimet korrente ndjek linjën e prioritetit strategjik të menaxhimit të kapitalit njerëzor, që konsiston në rritjen e kostove për përfitimet dhe kompensimet e punonjësve, mirëqenien dhe aktivitete sociale, edukimin dhe zhvillim profesional, si dhe ndonjë iniciativë tjetër strategjike për zhvillimin e kapitalit njerëzor. Rritja e parashikuar në këtë grup shpenzimesh reflekton edhe iniciativat strategjike lidhur me sigurimin e gatishmërisë operationale për procesin e kompensimit, në veçanti kryerjen e simulimeve për këtë qëllim përgjatë gjithë periudhës që planifikojmë.
- Planifikimi për zërin shpenzime kapitale është bërë në përputhje me objektivat strategjike të këtij plani. Koston më të lartë e zënë projektet për zhvillimin e infrastrukturës teknologjike, të cilat shoqërohen gjithashtu me kostot përkatëse në aktivet materiale në shërbim të tyre. Po kështu gjatë këtyre viteve do të merret në konsideratë edhe plotësimi nevojave institucionale në aktivet e tjera materiale që do të jenë në shërbim të veprimtarisë së institucionit.
- Gjatë planifikimit të shpenzimeve për tre vitet e planit strategjik, Agjencia ka marrë në konsideratë:
 1. Mbajtjen e treguesit të peshës specifike të totalit të shpenzimeve të planifikuara ndaj të ardhurave të planifikuara nga investimi i mjeteve financiare në nivelin 20-25%, dhe



2. Mbatjen e peshës specifike të totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave, në nivelin 3-6%.

Në tre vitet në vijim, Agjencia do të kryejë rishikim periodik, zbatim dhe monitorim efektiv të treguesve financiarë të dakortësuar të performancës, të cilët nxisin përdorimin me efikasitet të mjeteve financiare dhe minimizimin e variancave si dhe zvogëlimin e vonesave në realizimin e tyre.

Supozimet kyç të planifikimit

Supozimet mbi të cilat është bazuar ky planifikim konsiderohen se kanë ndikim thelbësor në realizimin e strategjive të parashikuara në këtë plan dhe buxhetet përkatëse.

Këto supozime janë si më poshtë vijon:

1. **Mandati Statutor**

Nuk do të pësojë ndryshime gjatë periudhës së planifikuar.

2. **Sistem bankar dhe financiar i qëndrueshëm**

Sistemi bankar dhe financiar pritet të vazhdojë të jetë i qëndrueshëm gjatë periudhës së planifikuar.

3. **Ngjarje sigurimi**

Bazuar në të dhënat dhe indikatorët që ka aktualisht në dispozicion, Agjencia nuk parashikon që gjatë periudhës së këtij plani strategjik të ketë ndonjë ngjarje sigurimi e cila do të kishte ndikim në të gjithë aktivitetin e Agjencisë.



Performanca e Planit Strategjik 2015-2017

Agjencia vlerëson se në përgjithësi progresi është i konsiderueshëm bazuar në tre drejtimet strategjike të Planit Strategjik 2015-2017, *Gatishmëria për kompensim; Menaxhimi efektiv i mjeteve financiar; dhe Ndërgjegjësimi publikut*. Ky progres u dëshmuar dhe nga çmimi ndërkombëtar “Përmirësimet e Sistemit të Sigurimit të Depozitave” me të cilin Agjencia u vlerësua nga Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave (IADI) në vitin 2016 si institucioni i sigurimit të depozitave me zhvillimet më thelbësore. Në tabelën e mëposhtme prezantohet ecuria e projekteve të parashikuara në kuadër të Planit Strategjik 2015-2017.

Strategjitë	Objektivat strategjikë	Projektet	Statusi	Koment
Gatishmëria e Agjencisë për kompensim	Bashkëpunim i ngushtë me GKSF për marrjen në kohë të informacionit në lidhje me institucionin me probleme dhe sigurimin në kohë të mjeteve financiare likuide.	Rishikimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë	Shtyrë	Ky projekt është shtyrë në vijim të miratimit të ndryshimeve në Ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave, i ndryshuar, për përfshirjen në skemën e sigurimit të depozitave të tregtarëve dhe shoqërive tregtare dhe shoqëritë e kursim-kreditit; miratimit të Ligjit 133/2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve nënligjore që burojnë nga Ligjet e sipërcituara. Është planifikuar që ky objektivi të përfshihet në planin strategjik 2018-2020.
		Plan për raportimet periodike të Agjencisë në GKSF	Realizuar	
	Përmirësimi dhe testimi i infrastrukturës ligjore, informatike dhe operacionale të Agjencisë për realizimin e	Plani i kontigjencës për likuiditet për çdo subjekt anëtar të skemës, në rast të një ngjarjeje sigurimi.	Në Proces	



procesit të kompensimit brenda afateve të synuara.	Rishikimi dhe plotësimi i kuadrit rregullator për kompensim	Realizuar	
	Testimi i stafit për realizimin e një procesi kompensimi	Nuk është Realizuar	Gjatë tre vjeçarit të kaluar Agjencia plotësoi kuadrin nënligjor për kompensim (rregullorja e kompensimit, plani i veprimit dhe manuali i simulimit). Në tre vitet e ardhshme këto testime Agjencia do t'i realizojë nëpërmjet procesit të simulimit.
	Kryerja e simulimeve vjetore	Realizuar	
	Automatizimi i dërgimit të të dhënave nga Agjencia tek BA	Nuk është Realizuar	Gjatë këtij tre vjeçari sistemi i raportimit pësoi ndryshime në vijim të ndryshimeve ligjore. Për këtë arsye ky projekt ka pasur një vonesë dhe është përfshirë në planin strategjik të Agjencisë për vitet 2018-2020.
	Ngritja e një serveri back-up për ruajtjen e të dhënave në sistemin informatik të Agjencisë për raportim dhe kompensim	Në Proces	Ky projekt u përfundua në fillim të vitit 2018 dhe është ende në proces implementimi.
	Marrëveshje bashkëpunimi me subjekte publike/private për ndërmjetësimin në kryerjen e pagesave dhe për komunikimin me depozituesit në rast kompensimi.	Realizuar	Marrëveshja me BA dhe subjekt mbështetës SIRK
Përmirësimi i cilësisë së mbajtjes së të dhënave për depozituesit nga subjektet anëtare të skemës.	Ndërgjegjësimi i Institucioneve Publike për t'iu mundësuar subjekteve të siguruara plotësimin/saktësimin e të dhënave identifikuese (numri personal, adresa e banimit).	Në proces	Agjencia ka bashkëpunuar me Shoqatën Shqiptare të Bankave, e cila ka ndikuar ndërgjegjësimin e institucioneve publike dhe subjekteve anëtare të skemës për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozituesve.




		Verifikime periodike në subjektet anëtare të skemës lidhur me saktësinë e mbajtjes së të dhënave.	Realizuar	
Menaxhim efektiv i mjeteve financiare	Përmirësimi i metodës së administrimit të rreziqeve lidhur me portofolin e investimeve, likuiditetin, kredinë dhe shpërndarjen e rrezikut në sistemin bankar	Procedurë për administrimin e rreziqeve të portofolit të investimeve te Agjencisë.	Realizuar	
		Metodologji për administrimin e rrezikut të likuiditetit për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë ne rast kompensimit.	Në proces	Vijon puna për përgatitjen e stres testeve, si fazë përfundimtare.
		Metodologji për monitorimin e shpërndarjes së rrezikut të bankave anëtare të skemës së sigurimit.	Realizuar	
		Metodologji për administrimin e counterparty risk lidhur me operacionet që Agjencia kryen me bankat në sistem.	Nuk është realizuar	Agjencia vlerëson joefektiv hartimin e një metodologjie për këtë rrezik.
	Planifikim realist dhe monitorim i vazhdueshëm i buxhetit vjetor	Rishikimi i procedurave dhe politikave për hartimin dhe zbatimin e buxhetit.	Në proces	
		Ndërtimi i modeleve standarde të raportimit për realizimin e projekteve të buxhetit nga njësitë përgjegjëse.	Në proces	



	Identifikimi dhe dakortësimi i treguesve standard të performancës financiare	Studim për identifikimin e treguesve të performancës financiare bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare të përshtatshme për natyrën e institucionit.	Nuk është realizuar	
		Rishikimi periodik i treguesve financiarë të dakortësuar të performancës.	Nuk është realizuar	
Ndërgjegjësimi i Publikut	Matja e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut	Anketim vjetor për matjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut	Realizuar	
	Komunikim i vazhdueshëm dhe efektiv me grupet e interesit	Strategji komunikimi me publikun	Realizuar	
Zgjerimi i skemës së sigurimit të depozitave	Përfshirja e SHKK-ve në SSD	Verifikime në SHKK për përmbushjen e kushteve për anëtarësimin në skemë	Realizuar	
		Automatizimi i sistemit të raportimit për shoqëritë e kursim kreditit (sistem raportues, shkëmbim të dhënash, kompensim).	Realizuar	



	Procesi i përfshirjes së SME-ve në SSD	Studim për vlerësimin e përfshirjes së SME-ve në skemën e sigurimit të depozitave	Realizuar	Përfshirja e SME-ve në SSD ka filluar që në 1 Janar 2017.
Identifikimi i drejtimeve të reja për një administrim më të mirë të Institucionit	Administrimi i Institucionit në përputhje me standardet ndërkombëtare të mirëqeverisjes, transparencës dhe komunikimit.	Vetëvlerësim për nivelin e përputhshmërisë së skemës së sigurimit të depozitave me parimet themelore për skema efektive të sigurimit të depozitave.	Shtyrë	Ky projekt, në zbatim të ligjit për sigurimin e depozitave, do të kryhet një herë në pesë vjet.
		Strategji për zhvillimin e burimeve njerëzore	Shtyrë	Strategjia e zhvillimit të burimeve njerëzore është një nga objektivat strategjike të Agjencisë të parashikuara për tre vjetorin e ardhshëm.
	Rritja e përgjegjësisë sociale të institucionit, nëpërmjet angazhimit në projekte me ndikim në komunitet	Identifikimi i projekteve sociale, pjesë e të cilave do të bëhet Agjencia	Realizuar	



Përfundim

Planit Strategjik 2018-2020, në të cilin përcaktohen objektivat strategjike të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, është një produkt i përbashkët i Këshillit Drejtues, ekipit drejtues dhe personelit të Agjencisë. Ky Plan ka për qëllim të arrijë angazhimin e të gjithë strukturave të Agjencisë për përmirësimin dhe forcimin e aftësive dhe kapaciteteve organizative në funksion të mandatit ligjor dhe misionit të institucionit. Ndërkohë që progres i konsiderueshëm është bërë në vijim të Planit Strategjik 2015-2017, jemi të ndërgjegjshëm që përpjekje të vazhdueshme janë të nevojshme për realizuar objektivat e Planit Strategjik 2018-2020. Ky Plan parashtron një sërë sfidash, të cilat synohet të tejkalohen duke u përqendruar tek rezultatet dhe monitorimi i kujdesshëm i performancës në të gjitha aspektet operacionale dhe organizative. Realizimi i objektivave të Planit Strategjik 2018-2020 do të na përafrojë me vizionin e Agjencisë që të jemi siguruesi i depozitave që meriton besimin e publikut.